

NE GJYKATEN KOMUNALE TE PRIZRENIT
Ceshtja P. Numer 351/10
14 Korrik 2010

NE EMER TE POPULLIT

Gjyqtari Malcolm Simmons Krytar ne Trupin Gjykues me anetare Gjykatësit Vaton Durguti dhe Fahri Tershnjaku me procesmbajtes; Christin Nilsson dhe Robert Abercrombie, në ceshtjen penale kundër Elez Hoxhes (në tekstin ne vijim "I pandehuri"), i akuzuar në bazë të aktakuzes PP. 1916-1909 ngritur nga Prokuroria Komunale në Prizren, datë 8 Gusht 2009 lidhur me veprën penale Pranimi i Ryshfetit sipas Nenit 343 (1) te Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin ne vijim "KPPK"), pas mbajtjes se seancave te Gjykimit Publik në 1 Korrik 2010, 2 Korrik 2010 dhe 13 Korrik 2010 në të cilën Znj. Gabriëla Walentich prezantoi Prokurorinë Komunale dhe te pandehurin, i cili ishte i paperfaqesuar, më 14 Korrik 2010 mori dhe publikisht dhe shpalli si në vijim kete

AKTGJYKIM

I pandehuri Elez Hoxha, emri i babait Tahir Hoxha emri i nënës Vogla Cuni, i lindur më 16 Dhjetor 1948 në fshatin Gjonaj, Komuna e Prizrenit, aktualisht me vendbanim në Matican, Rruga Isa Kastrati, Numri 306, Prishtinë, numri i dokumentit te leternjoftimit 1004375242, i martuar, baba i tre fëmijëve, Jurist, Kosovar - Shqiptar, me gjendje financiare mesatare, është

FAJTOR

Për shkak se gjatë viteve 2005/2007 i akuzuari, ndërsa ka qene gjykates i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës si rrjedhoje një person zyrtar në kuptim të Nenit 343 të KPPK-së, me ndërmjetësimin e Agim Zekes, ka pranuar nga Vesel Alshiqi para në shumën 53,000 Euro dhe një automjet Kadi Volkswagen, të cilin ai e ka marre për djalin e tij, dhe se ai ka pranuar nga Vesel Alshiqi shuma të tjera parash, të gjitha me qëllim që ai të kryente brenda fushëveprimit të autoritetit të tij zyrtar një veprim zyrtar apo tjetër i cili nuk duhet të kryhej ose të dështonte në kryerjen e një

veprimi zyrtar apo tjetër të cilin ai duhet te kryente, konkretisht lirimin e Afrim Alshiqit dhe / ose Besim Alshiqit që ishin secili të akuzuar për vrasje, ose, që ndaj tyre te vendosej nje denim i paarsyeshem me i butë. Në një takim të mëvonshëm me pejsmarrjen e Vesel Alshiqit dhe Ramadan Alshiqit, në shtëpine e ketij te fundit, i pandehuri i dha Ramadan Alshiqit një zarf që mbante para në shumën prej rreth 59.000 euro ose 61.000 euro duke shenuar kjo kthimin e një pjesë te parave ryshfet që i pandehuri kishte pranuar nga Vesel Alshiqi.

Për shkak të kesaj i akuzuari ka kryer veprën penale Pranimit i Ryshfetit sipas Nenit 343 (1) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe është

DENUAR

me burgim per nje periudhe kohore prej 4 (katër) vjet. Më tej, në përputhje me Nenin 54 (2) të Kodit Penal të Kosovës, Gjykata vendos një gjobë prej 10.000 (dhjetë mijë) Euro.

Sipas Nenit 73 të Kodit Penal të Kosovës, ne dënimin me burgim, do të merret parasysh koha e kaluar ne arrest shtëpiak, do të merret parasysh periudha nga 27 Qershori - 24 Shtator 2008.

Në pajtim me Nenin 102 (1) te Kodit të Procedurës Penale të Kosovës i pandehuri do të paguaj shpenzimet e procedures penale. i pandehuri do të paguaj shumën prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) Euro në lidhje me shumën e caktuar.

Sipas Nenit 391 (1) (6), aktgjykimi perfundimtar mund të shpallet në mediat publike.

ARSYETIM

Zyra e Prokurorise Komunale të Prizrenit ka ngritur aktakuzen numer PP. 1916-1909 te datës 8 Gusht 2009 kundër te pandehurit Elez Hoxha, gjykates i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe atij Agim Zeka, të cilët ishin akuzuar perkatesisht për veprat penale të Pranimit te Ryshfetit sipas Nenit 343 (1) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe Dhënia e Ryshfetit sipas Nenit 344 (1) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Seanca e parë e Gjykimit Kryesor në këtë lëndë filloi më 23 Mars 2010 dhe rifilloi më 26 Maj, 31 Maj, 8 Qershor dhe 9 Qershor 2010. Pas shtyrjes së seances kryesore më 9 Qershor përbërja e trupit gjykues ndryshoi. Neni 345 i KPPK-së parashikon se kur përbërja e panelit të gjykimit ka ndryshuar, Gjykimi Kryesor i shtyrë do të fillojë nga e para. Si pasojë e saj, më 1 Korrik 2010 ka nisur një gjykim i ri kryesor.

Në fillim të Gjykimit Kryesor të parë, Agim Zeka u deklarua fajtor për shkelje të dispozitave Dhënia e ryshfetit sipas Nenit 344 (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Pas kësaj, sipas Nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Gjykata nxori një Aktvendim ku urdhëroi ndarjen e procedurës ndaj të pandehurve të lartpërmendur.

Në aktakuzë ishte pohuar se gjatë viteve 2005/2007 Vesel Alshiqi, në disa raste, me ndërmjetësimin e Agim Zekes, i ka dhënë të akuzuarit, gjatë kryerjes së detyrave të gjykatesit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, si rrjedhojë një person zyrtar, para në shumën totale prej 123.000 Euro dhe një makinë-automjet Volkswagen Kadi në mënyrë që i pandehuri, brenda fushëveprimit të autoritetit të tij zyrtar, të kryente një akt zyrtar të cilin ai nuk duhet ta kryente - specifikisht për shfajësimin ose të paktën lirimin e Afrim Alshiqit dhe Besim Alshiqit që ishin të akuzuar, secili, për vrasje. Sipas pretendimeve të aktakuzës i pandehuri si rrjedhojë ka kryer veprën penale të Pranimit të Ryshfetit sipas Nenit 343 (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

1. Provat Deponuese

Ne Gjykimin e parë kryesor janë deponuar deshmite e tre deshmitareve: Oficeri i Bronislav Prochazka, Ramadan Alshiqi dhe Agim Zeka.

Ne fillim të Gjykimit të dytë Kryesor, sipas Nenit 345 të KPPK-së me dakordimin e paleve, Kolegji pranoi deshmite e katër deshmitareve të dhena në Gjykimin e parë Kryesor. Deklaratat e secilit deshmitar janë lexuar për procesverbalin.

Bronislav Prochazka, është Oficer i policise në shërbim të Forcës Policore të Republikës Çeke, i derguar në Misionin e EULEX-it në Kosovë. Ai dëshmoi më 26 Maj 2010 gjatë gjykimit të parë kryesore.

Gjatë periudhes Shtator 2007 - Nëntor 2008 oficeri Prochazka punonte me UNMIK-un si hetues ndërkombëtar në Njësinë e Hetimeve Speciale (në tekstin në vijim "SIU").

Në fillim të 2008-tes policia u kontaktua nga Vesel Alshiqi që kishte informacion lidhur me korrupsionin e dyshuar gjyqësor. Rasti eshte derguar ne SIU.

Oficeri Prochazka ka marre deklarata nga Vesel Alshiqi ne 11 Janar 2008¹ dhe 29 Prill 2008² dhe nga Ramadan Alshiqi ne 16 Maj 2008³. Raporti i oficerit Prochazkas date 8 Prill 2008 eshte bere gjithashtu pjese e provave⁴

Në Raportin e tij, oficeri Prochazka iu referua informatave të tij te marra më 11 Qershor 2008 nga Vesel Alshiqi lidhur me rryshfetin e dyshuar ku përfshihet i pandehuri. Është e qartë qe muaji të cilin oficeri Prochazka e përmend në Raportin e tij është i pasaktë. Data e Raportit është 8 Prill 2008. Më tej, deklarata e parë e Vesel Alshiqit është bërë më 11 Janar 2008. Raporti ne fjale duhet të ketë, pra, ti jete referuar informatave që janë marrë më 11 Janar 2008. Gjykata konstaton se ishte një gabim shtypi.

Në Raportin e tij, Oficeri Prochazka ka shenuar të dhënat e informacionit që kishte marrë gjatë intervistës së tij me Vesel Alshiqin më 11 Janar 2008.

Vesel Alshiqi informoi Oficerin Prochazka se ai kishte qenë i kontaktuar nga Agim Zeka i cili i kishte ofruar për të vepruar si ndërmjetësues në mes Vesel Alshiqit dhe te pandehurit.

Oficeri Prochazka dëshmoi në seancën e parë kryesore që Vesel Alshiqi e kishte informuar atë se ai i kishte dhënë para të akuzuarit direkt dhe përmes ndërmjetësimit të Agim Zekes. Ai më tej dëshmoi për një automjet Kadi Volkswagen

¹ Prova P1

² Prova P2

³ Prova P3

⁴ Prova P4

me numer të regjistrimit 488-KS-189 që Vesel Alshiqi i kishte dhënë të pandehurit.

Oficeri Prochazka dëshmoi se Vesel Alshiqi e informoi atë se parate dhe automjeti ishin menduar si një ryshfet për të siguruar lirimin e vëllezërve të tij Afrim Alshiqi dhe Besim Alshiqi. Të dy ata janë akuzuar për vrasje.

Oficeri Prochazka u pyet nga prokurorja nëse ai mund ta kujtonte shumën e parave që Vesel Alshiqi i kishte dhënë të akuzuarit. Ai dëshmoi

"Ate e mbaj mend mjaft mirë, një sasi e madhe parash kjo, sidomos për një vend si Kosova, në atë kohë kjo, ishte rreth 130 000 Euro, vlera e ryshfetit ishte rreth 130, 000 duke përfshirë automjetin"

Kjo dëshmi konstatohet që është thashethem (fjale te pakonfirmuara) në atë se Oficeri nuk kishte njohuri personale se sa para, nëse janë dhene, i ka dhënë Vesel Alshiqi të akuzuarit. Raporti i tij dhe dëshmia e tij në këtë drejtim janë bazuar mbi atë që ai thotë se Vesel Alshiqi i ka treguar.

Gjatë takimit të tyre fillestar Vesel Alshiqi i dha Oficerit Prochazka pesë CD që përmbanin regjistrimet e bisedave në mes të të akuzuarit dhe anëtarëve të familjes Alshiqi. Këto incizime janë bërë nga anëtarët e familjes Alshiqi. Oficeri Prochazka intervistoi më pas Ramadan Alshiqin që identifikoi zërat në CD.

Oficeri Prochazka dëshmoi për kërkimet që ai kishte kryer në bazë të të dhënave përkatëse për të përcaktuar identitetin e personit në posedim të automjetit Kadi Volkswagen për të cilën ai kishte marrë informacion nga Vesel Alshiqi.. në raportin e tij⁵, Oficeri Prochazka theksoi se automjeti në fjale ishte i regjistruar me emrin "Armand (Elez) Hoxhaj i Datelindjes 01/07/1977".

Oficeri i Prochazka dëshmoi se ai e kishte parë një DVD që përshkruante një takim në mes të të akuzuarit dhe anëtarëve të familjes Alshiqi. Regjistrimi është bërë nga familja Alshiqi. Ai e përshkroi të pandehurin duke i dorëzuar një zarf Vesel Alshiqit. Në fakt, në DVD i akuzuari mund të

⁵ Prova P4

shihet ndersa i jep një zarf Ramadan Alshiqit i cili, nga ana e tij, ja jep atë Vesel Alshiqit. Oficeri Prochazka dëshmoi:

"Vesel Alshiqi me tha se Elez Hoxha, i solli atij parate mbrapsh, sepse ai nuk ishte në gjendje ta ndihmonte ne këtë çështje - për të nxjerrë vëllezërit e tij nga burgu. Faktikisht ai nuk pati sukses."

Ramadan Alshiqi dëshmoi më 31 Maj 2010 gjatë gjykimit të parë kryesor. Ai dha një deklaratë për Oficerin Prochazka në 16 Maj 2008⁶. Ai dha një deklaratë më tej në 10 Qershor 2008⁷.

Ramadan Alshiqi ishte disi i paqartë, kur ai dëshmoi në gjykimin e parë kryesor në lidhje me detajet e bisedave me të pandehurin, duke përfshirë ketu se kush ishte i pranishëm dhe çfarë u diskutua.

Në vlerësimin e dëshmisë së tij, kjo gjykate është e ndërgjegjshme për pjesëmarrjen e vetë Ramadan Alshiqit në veprat penale dhe faktin se i pandehuri ishte kryetari i trupit gjykues që kishte dënuar djemtë e Ramadan Alshiqit Afrim dhe Besim Alshiqin dhe i dënoi ata me burgim afatgjatë.

Në vlerësimin e provave Gjykata ka konstatuar se kjo dëshmi e Ramadan Alshiqit u mbështet si nga provat e dokumentuara dhe deklaratat e dëshmitarëve të tjerë.

Ramadan Alshiqi dëshmoi në gjykimin e parë kryesor që djali i tij, Vesel Alshiqi, kishte takuar të pandehurin në disa raste. Ai pranoi që ishte i pranishëm në shumicën e këtyre takimeve. Ai nuk mund të kujtoj datat e këtyre takimeve.

Megjithatë, Ramadan Alshiqi dëshmoi se takimi i parë me të pandehurin ka ndodhur para se të shpallej aktgjykimi në rastin e Besim dhe Afrim Alshiqit. Aktgjykimi në këtë rast është dhënë më 10 Mars 2006.

Ramadan Alshiqi u pyet për ryshfetin dhënë të pandehurit.

Prokurorja: *"A ishit ju i pranishëm kur me shume se 123,000 Euro iu dhane Elez Hoxhes?"*

⁶ Prova P3

⁷ Prova P5

Ramadan Alshiqi: "Une isha gjate tere kohes me djalin tim."

Prokurorja: "Cfare te tha ty Veseli?"

Ramadan Alshiqi: "Ai më tha se ai i kishte dhënë Elez Hoxhes 123.000 euro dhe ai solli një makinë për atë nga Austria, ku ai është shtetas. Unë besoj se Elez Hoxha është ende në posedim të asaj makine, ai ia dha atij makinën përmes Agim Zeka."

Prokurorja: "Djali juaj ju ka thene qe ai i dha 123,000 Euro... [te pandehurit]?"

Ramadan Alshiqi: "123,000 Euro dhe makinen ..."

Kjo dëshmi konstatohet si thashethem në atë që Ramadan Alshiqi nuk pretendoi të kishte njohuri personale se sa para i janë dhënë te akuzuarit nga Vesel Alshiqi. Dëshmia e tij është e bazuar mbi atë që ai thotë se Vesel Alshiqi i kishte thene. Megjithatë, në vështrimin e provave CD⁸, Ramadan Alshiqi personalisht ia ka dorëzuar paratë te pandehurit në shumën totale prej 73.000 Euro. Në arritjen e vendimit te saj Gjykata është mbështetur kryesisht në dëshmitë e tij. .

Ne deklaratën e tij të datës 16 Maj 2008⁹ Ramadan Alshiqi tha:

"I dhashe të gjitha paratë e mia dhe pronën Veselit e më pas ai më tha se ai ka paguar 130.000 euro ... gjykatësit."

Përsëri dhe kjo konstatohet thashethem. Ramadan Alshiqi nuk pohoi të kishte njohuri personale se sa para, nëse po, i janë dhënë të pandehurit, por mbështetet në atë që Vesel Alshiqi i ka thene atij. Në pyetjen e prokurores se pse i pandehuri kërkoi para, Ramadanit Alshiqi tha

"Në mënyrë që t'i japë atij një dënim në pajtim me ligjin dhe jo kundër ligjit."

Megjithatë, më vonë në dëshminë e tij, duke iu referuar një takim pasues me të pandehurin, Ramadan Alshiqi deklaroi

⁸ CD 7, Prova P8

⁹ Prova P3

"... Kemi biseduar se si të merrej një dënim më i butë, kjo është ajo që ne biseduam."

Më 16 Maj 2008 Ramadan Alshiqi ka qene në zyrat e SIU-t ku atij i është treguar një DVD¹⁰. Ai deklaroi DVD u regjistrua në shtëpinë e tij në Prishtinë. Ai nuk mund ta kujtonte datën. Ai deklaroi se ne DVD shfaqej vete ai, Vesel Alshiqi dhe i pandehuri.

Ai më tej dëshmoi se i pandehuri erdhi në shtëpinë e tij në katër raste. Kur ai deklaroi përpara kësaj Gjykate Ramadan Alshiqi theksoi se gjatë një prej këtyre takimeve i pandehuri i ktheu para Vesel Alshiqit. Ai deklaroi

"... Elez Hoxha erdhi në shtëpinë time katër here dhe na kërkoi të mos e raportojnë, ai i solli atje ... dhe kjo mund të shihet në një video. Në rastin e parë ai solli 59.000 Euro dhe ne nuk i pranuan të hollat në atë rast. Heren e dytë ai solli 61.000 Euro dhe keto ne i pranuan. Ai ishte atje me gruan e tij, Sadijen, dhe ne atje pime kafe. "

Ramadan Alshiqi dëshmoi më vonë se ai nuk mund të kujtojë, nëse shuma që ai tha se i pandehuri i kishte kthyer ishte 59.000 apo 61.000 euro. Në të vërtetë, kjo ishte në përputhje me deklaratën e tij të 16 Majit 2008.

Ramadan Alshiqi dëshmoi në gjykimin e parë kryesor që kur ishte pyetur se pse i pandehuri donte të kthehen paratë. Në përgjigje ai tha

"Ndoshta ai ka marrë më shumë se ai duhet të ketë nga pala e dëmtuar."

Ky ishte një pohim absurd.

Oficeri Prochazka dëshmoi se Vesel Alshiqi i tha atij se i pandehuri i ka kthyer të hollat, sepse

"Ai nuk ishte në gjendje ta ndihmonte me këtë çështje - për të nxjerrë vëllezërit e tij nga burgu. Në fakt ai nuk pati sukses. "

¹⁰ Prova P10

Përsëri, kjo prove konsiston ne fjale te degjuara.

Në të vërtetë, në deklaratën e tij të 16 Majit Ramadan Alshiqi 2008 ka deklaruar se i akuzuari donte të kthente "paratë e ryshfetit" që ai kishte marrë nga Vesel Alshiqi. Ai tha se i akuzuari u tha atyre se ai i kishte kthyer paratë, sepse

"Ai nuk ka zgjidhur punë"

Ramadan Alshiqi dëshmoi se ai i dëgjoi CD-te e bisedave me të pandehurin mbi të cilat Prokuroria është mbështetur. Ai ka deklaruar se e ka njohur zërin e tij, zërin e djemve të tij dhe te te pandehurit.

Kur ai u intervistua nga policia më 16 Maj 2008, Ramadan Alshiqit iu kërkua për të dëgjuar CD-ne 2¹¹ dhe 4¹² mbi të cilat është mbështetur prokuroria. Ai ka identifikuar zërin e tij, atë të Vesel Alshiqit dhe te te pandehurit.

Kur ai u intervistua nga policia më 10 Qershor 2008, Ramadan Alshiqit iu kërkua për të dëgjuar Cd-te 3¹³, 5¹⁴, 7¹⁵, 8¹⁶ dhe 9¹⁷.

Në CD-te 3, 5 dhe 7 Ramadan Alshiqi identifikoi zërin e tij dhe atë të Vesel Alshiqit dhe te te pandehurit.

Në CD-te 8 dhe 9 Ramadan Alshiqi identifikoi zërin e tij dhe ate të djemve te tij Vesel Alshiqi dhe Naman Alshiqi dhe atë te te pandehurit.

Natyrisht, Ramadan Alshiqi ishte i pranishem ne takimet kur DVD-ja dhe tre CD-te¹⁸ jane incizuar.

Është e qartë që sa i perket proves se CD-ve Ramadan Alshiqi ka luajtur një rol më qendror se sa ai i portretizuar në Gjykatë.

¹¹ Prova P8

¹² Prova P8

¹³ Prova P8

¹⁴ Prova P8

¹⁵ Prova P8

¹⁶ Prova P8

¹⁷ Prova P8

¹⁸ CD-te 3, 5 dhe 7

Gjykata u mjaftua me ate qe ky fakt nuk e dëmtoj vlerën provuese të provave të tij që ishte, sidoqofte, e mbështetur nga prova te dokumentuara dhe prova te tjera deshmuese.

Agim Zeka, dha deklarate më 8 Qershor, 2010 në gjykimin e parë kryesor, lidhur me që ate e kishte kontaktuar Vesel Alshiqi i cili i kërkoi atij që të veprojë si ndërmjetës në lidhje me marrveshjen e ketij te fundit me të akuzuarin. Ai tha se ai e dinte se i pandehuri ishte Kryetari i Trupit Gjykues në rastin e Afrim dhe Besim Alshiqit.

Ndërsa kryen rolin e ndërmjetësit, Agim Zeka deklaroi se ai kishte marrë nga Vese Alshiqi para ne dore në shumën prej 53.000 euro dhe një makinë-automjet Volkswagen Kadi. Ai tha se ishte djali i të akuzuarit ai qe e mori automjetin prej tij. Atij nuk i kujtohej emri i djalit të te akuzuarit. Agim Zeka u pyet se pse Vesel Alshiqi ia dha Volkswagen Kadi të akuzuarit.

Ai dëshmoi se ai vetëm mori pjese ne një takim midis Vesel Alshiqit dhe te pandehurit. Ky takim u mbajt në pompen e benxines Rama në rrugen Prishtinë - Shkup. Ai dëshmoi se ai i dha 53.000 Euro të akuzuarit para takimit në pompen e benzinës. Ai tha se takimi në pompen e benzinës ishte pas shpalljes se aktgjykimit në rastin e Afrim dhe Besim Alshiqit. Megjithatë, kjo eshte kontradiktuar nga dëshmia e tij më pas në lidhje me datën e regjistrimit të automjetit.

Agim Zeka tha se nuk mund ti kujtojë datat kur i dha parate të akuzuarit. Ai tha se ka marrë para nga Vesel Alshiqi në këste 2 ose 3 here, së bashku ne vlerën 53.000 Euro. Ai deklaroi, megjithatë, se i dha një pjesë të parave nga shuma 53.000 Euro te akuzuarit para se ti dorezonte automjetin Kadi Volkswagen djalit të tij dhe disa para te tjera pas dhenies se automjetit.

Agim Zeka u pyet se pse Vesel Alshiqi kishte dhënë një automjet për të akuzuarin. Në përgjigje ai deklaroi

Agim Zeka: *Te gjithë kete ai e beri per shkak te vellezerve te tij.*

Kryetari i Trupit Gjykues: *Perse?*

Agim Zeka: *Ne menyre qe te mundesonte lirimin e*

Besimit pasi ai ishte i pafajshem.

Kryetari i Trupit Gjykses:...automjeti dhe parate jane dhene ne menyre qe te liroheshin vellezerit nga burgu pasi ata ishin te pafajshem?

Agim Zeka: Po, per ate arsye.

Agim Zeka deklaroi se në 2000-shin i biri i të akuzuarit kishte blerë prej tij atë që ai e përshkroi si një "furgon VW".

Gjykata vlerësoi motivimin e Agim Zekes për të dhënë dëshmi të rreme. Në fakt, Agim Zeka nuk kishte asgjë për të fituar nga dhënia e dëshmise së rreme por shume për të humbur. Bazuar në pohimet e tij, Agim Zeka pas pranimit te fajësisë, është dënuar për shkelje te Nenit 344 të LPK-se dhe është dënuar me një burgim prej 12 muajve.

I pandehuri deklaroi mbrojtjen e tij.

Në thelb, mbrojtja e tij ishte se dëshmitë e familjes Alshiqi, në konspiracion me Agim Zeken, ishin fabrikuar për tu hakmarre për faktin se pandehuri kishte shpallur fajtor Besim Alshiqin dhe Afrim Alshiqin dhe denuar ata me burgim të gjatë.

Më tej, ose si alternative ai pohoi se ndjekja e tij penale ishte pjesë e një skeme të përpunuar për të siguruar një gjykim të ri të Besim Alshiqit dhe Afrim Alshiqit.

Ai pretendoi se kishte marrë kërcënime personalisht nga familja Alshiqi, ai pohoi, se keto ishin rezultat i denimit te marre nga kolegji i tij kunder Besim Alshiqit dhe Afrim Alshiqit. Ai tha se nuk kishte raportuar ndonjë nga këto kërcënime në polici ose në stafin pergjegjes per sigurinë në Gjykatën e Qarkut.

Ai mohoi qe te kishte marrë para nga ndonjë anëtar i familjes Alshiqi, personalisht ose nëpërmjet një ndërmjetësi.

Duke iu referuar automjetit Volkswagen Kadi, ai tha se djali i tij e kishte blerë këtë makinë nga Agim Zeka dhe se djali i tij kishte paguar çmimin e blerjes prej 3.800 - 3.900 euro me këste. Gjykata kishte dëgjuar më parë

deklaraten nga Agim Zeka se ai e shiti një "furgon VW " djalit të te pandehurit në 2000-shin. Gjykata konstaton se këto janë automjete të ndryshme.

Gjykata ka dëgjuar dëshmitë e Ramadan Alshiqit se ai ishte i pranishëm në takimet me të pandehurin kur DVD-ja dhe tre¹⁹ CD-te janë incizuar.

Më tej, Gjykata degjoi deklaratën se Ramadan Alshiqi identifikoi në DVD dhe CD zërin e të akuzuarit, zërat e djemve të tij dhe zërin e tij.

I pandehuri e mohoi që zëri i tij dëgjohej në ndonjerën prej CD-ve mbi të cilat prokuroria mbështetet. I pandehuri gjithashtu mohoi se është një nga personat e shfaqur në DVD

2. Provat e dokumentuara

Prokuroria ka evidentuar si prove 7 CD²⁰ dhe transkriptet e tyre përfshirë regjistrimin e bisedave midis Vesel Alshiqit dhe te pandehurit. Ramadan Alshiqi ishte i pranishëm gjatë disa prej këtyre takimeve.

Prokuroria gjithashtu paraqet si evidencë një DVD²¹ të një takimi të mëtejshëm në mes të të akuzuarit dhe anëtarëve të familjes Alshiqi.

Nuk ka patur prova të paraqitura që ti vinin në ndihmë Gjykatës për të konkluduar në përcaktimin e datave kur çdo takim është incizuar.

I pandehuri kundërshtoi pranueshmërinë e audio incizimeve dhe regjistrimeve video, sepse, ai pohoi, ato janë kryer, marre në mënyrë të paligjshme.

Provat e CD-ve dhe DVD-se do të ishin të papranueshme nëse marrja e regjistrimit do të ishte e dënueshme sipas KPPK-se.

Në bazë të Neneve 170 dhe 171 të KPPK-së, një regjistrim

¹⁹ CD's 3, 5 and 7

²⁰ Prova P8

²¹ Prova P10

është i paautorizuar ose nëse biseda e regjistruar audio nuk i drejtohet atij (neni 170 paragrafi 1 i KPPK-se), ose video incizim është bërë në hapësirat personale të personit të regjistruar pa pëlqimin e tij (neni 171 paragrafi 1 KPPK). Vesel Alshiqi ka incizuar vetëm bisedave në të cilat ai mori pjesë dhe video incizim është bërë në mjediset e familjes Alshiqi. Prandaj regjistrimet nuk janë prova të papranueshme.

Për më tepër, dispozitat e KPPK-se sigurojnë masa mbrojtëse ligjore për të pandehurin nga shkeljet e ligjit, lëshime procedurale, keqpërdorimin e të drejtave tij apo të saj dhe shkeljet e të drejtave ose kufizimet e të drejtave juridike nga personat zyrtarë gjatë zbatimit të Procedurës Penale. Këto dispozita sigurojnë masa mbrojtëse për të pandehurin dhe ndalojnë përdorimin e provave të mbledhura në kundërshtim me dispozitat formale ose materiale në procedurën penale. Dispozitat mbi provat e papranueshme duhet të kuptohen në një mënyrë të kufizuar, pa lejuar ndonjë analogji

Palët mund të ngrenë çështjen e pranueshmërisë së provave, pasi provat e tilla janë paraqitur në gjykatë dhe në veçanti gjatë konfirmimit të aktakuzës, më vonë kjo mund të bëhet vetëm nëse palët argumentojnë se ata nuk kishin informacione të mëparshme për këtë dëshmi, ndërsa gjykata mund të ngrejë çështjen sipas detyrës zyrtare kurdoherë që prova të tilla janë paraqitur para gjykatës ose kur ekziston dyshimi mbi ligjshmërinë e provave (neni 154 paragrafi 2, neni 306 paragrafi 3, neni 319 paragrafi 3).

Gjykata konstaton se regjistrimet audio dhe video janë bërë në mënyrë të ligjshme, ato janë të rëndësishme dhe për këtë arsye të pranueshme në këtë procedure.

Gjykata urdhëroi që të gjithë 7 CD-te dhe DVD-ja të degjohen dhe shihen në Gjykatë.

2.1 Audio regjistrimet

Të gjitha CD-të mbi të cilat Prokuroria u mbështet u degjuan në Gjykatë. Cilësia e audio play-back e CD-ve të regjistruara ishte e mirë.

Paneli ishte i preokupuar në lidhje me saktësinë e transkripteve të cilat u pranuan si prova. Prandaj, Paneli zgjodhi të mbështetet në audion aktuale të CD-ve dhe DVD-se se regjistruar.

CD 2²²

Bisedat midis Vesel Alshiqit dhe të pandehurit.

...

Vesel Alshiqi:...Ti e di se si shkuan gjërat. Agimi ka folur me ju, por Baca Elez, unë kam provuar të bëj diçka për ju. Unë nuk e di se çfarë mendoni për mua, por unë kam provuar. Agim Ndoshta nuk e ka mbajtur fjalën e tij. Dua të them se deri tani, në qoftë se ju doni mund të thoni se Veseli është i tinëzar, mendoni si ju të dëshironi, por Agimit I kam thënë një vit më parë, dhe ju gjithashtu më thate se këto gjëra janë marrë dhe ju thate se ai është i pafajshëm. Por tani unë nuk e di se çfarë të bëj. Baca Elez, ju keni marrë mbi 50.000 € para gjyqit.

...

I pandehuri: Le të shikojmë për të premtën pasi kam qenë i zënë. Unë nuk kam pasur kohë se ka patur mjaft njerëz në ngushëllime dhe nuk kishte kohë për këto dhe gjëra të tjera.

I pandehuri: Shiko Vesel, ju kam thënë, unë mund të behem shërbëtori juaj, Do ta tregoj me detaje se si ... (është ndërprerë nga Veseli)

Vesel Alshiqi: Unë po ju pyes përsëri, Më vjen keq që ju keni pasur shumë shpenzime, më kuptoni. Dëgjoni me kujdes, ju po flisni me Veselin. Për atë që kemi biseduar unë jam duke u përpjekur të them se deri... 80.000 € përafërsisht kam shpenzuar, ti kam dhënë ty keto. Dëgjoni, 50.000 € i kam. Baca Elez, unë nuk dua t'ia di as për 10 cent. Unë e di që ju keni pasur shumë shpenzime për djalë tuaj. Mos me keqkuptoni mua, ne i kemi hyrë kësaj tani, nuk e di nëse ju me kuptoni, unë jam njeri i ndershëm. Lirisht ju mund të thoni: "Vesel mos kërkoni për para gjekundi. Unë nuk e di nëse ju me kuptoni mua. Lirisht ju mund të thoni:

²² Prova P8

Vesel, unë jam shërbëtori yt, dhe unë kam arritur në këtë pikë '. Të premtën ne mund të takohemi për të sqaruar gjërat. Unë po ju lutem juve nëse ju nuk bëni diçka për mua unë jam i shkatërruar.

I pandehuri: Unë ju kam thënë, do t'ju tregoj me detaje se si janë gjërat, unë nuk munda. Kemi folur së bashku se si gjërat kanë ardhur deri këtu, më lejoni të bëhem shërbëtori juaj dhe mos...

Gjykata konstaton kur i referohet "Agimit" është fjala për Agim Zeken. Djali i te pandehurit kishte vdekur pak kohë para për kësaj bisede. I Pandehuri i referohet që ai kishte pritur për "ngushëllimet". Ka një diskutim në lidhje me të holla. Gjatë kësaj bisede pandehuri i thotë se "Unë mund të jem shërbëtori juaj". Kjo është dëshmi e qartë e synimit të tij.

CD 3²³

Biseda midis Vesel Alshiqit dhe te pandehurit.

...

Vesel Alshiqi: Kam ardhur të premtën. Unë thjesht kam ardhur për t'ju pyetur se çfarë keni bërë për mua, sepse gjendem në një situatë të bllokuar plotësisht. Para së gjithash, ju e dini se si gjërat janë zhvilluar. Axha Elez, unë jam një njeri i cili u përpoq shumë për ju. Çka do të bëni Xha Elez? Unë dua të di se sa kohë do të marrë kjo gjë. Ju jeni i vetëdijshëm se në 28 ne kemi një seancë dëgjimore në Gjykatën Supreme, Gjykata me lartë në Kosovë. Unë as që do ti hedh syte përreth. Çka do të bëni axha Elez? Unë dua ta di më burrë, sepse jam pas murit tani. Unë nuk di se ku tjetër të shkoj! Unë dua të them se unë jam perpjekur shumë për ju, unë shpresoj te ti, dhe unë do të mbaj fjalën time - që ju kam dhene. axha Elez, jam perpjekur aq shumë, unë jam ne hall, njeri. Familja ime nuk është ballafaquar me një problem të tillë kurre në të kaluarën. Se pari, o burrë, është mendimi im se mua më janë mbledhur të gjitha të keqiat të këqijat, kanë ardhur tek unë! Sa i përket rastit, sa i përket çdo gjëje - une jam perpjekur për ju. Ti e di shumë mirë që kam i bërë të gjitha që kam mundur

dhe kam përdorur cdo gje qe kam pasur. Ti e di axha Elez, unë ju dhashe 80,000 euro dhe ju thashë se do t'ju jap edhe nje tjeter 50,000 ditën qe axha Elez me thote "Është kryer"

I pandehuri: A e ke te fikur telefonin?

I pandehuri: Ju kam thënë unë do të jem aty deri ditën e fundit ... Unë do të bëj çdo gjë qe të jetë e mundur ...

Vesel Alshiqi: Axha Elez si mendoni? Sa kohe mund te vonohet kjo?

I pandehuri: Sa vonohet? Ata nuk e dine se sa kohe do ta vonojne per secilin?

Vesel Alshiqi: Gjykata Supreme po thote nga 15 dite deri ne nje muaj.

I pandehuri: Po keshtu eshte.

Vesel Alshiqi: Deri sa te dergohet perseri mbrapsh?

I pandehuri: Mund te ndodhi edhe me shpejt dhe mund te vonohet edhe pak gjithashtu, por nuk eshte...

Vesel Alshiqi: Një muaj nuk është problem. Por cfare mendon, axha Elez, deri sa të arrijë te ju për shembull? Ky është vetëm një shembull. Do të arrijë te ju për dy muaj.

I pandehuri: Jo, jo. Unë besoj se Gjykata e Lartë nuk do ta shtyjë atë për më shumë se një muaj dhe pastaj do të vij drejt e te une.

Vesel Alshiqi: Kjo do te thote...! A do te vije te ju apo i shkon Kryetarit te Gjykates se Qarkut?

I pandehuri: Vjen te une.

Vesel Alshiqi: Pas sa kohe atëherë besoni se do të fillojë gjykimi? Unë po te them o burre, unë dua të di pak për disa gjëra. Ju nuk eshte nevoja të thoni ditën e saktë.

I pandehuri: Unë do të ... Mund të ndodhë së pari qe

... kjo mund të jetë për 15 ditë, 20 ditë apo një muaj. Pasi është kthyer për mua atëherë ajo ka asgjë për të ...

Vesel Alshiqi: Cfare mendoni, se si do te shkoje me pas, lloji i gjykimit per shembull?

I pandehuri: Le te mos flasim per kete tani.

Vesel Alshiqi: A do te lirohet djali perpara apo pas séances?

I pandehuri: Jo perpara séances...

Vesel Alshiqi: Do me thene qe nuk ka absolutisht asnje shanc perpara se te mbaroje cdo gje?

I pandehuri: Jo.

Vesel Alshiqi: Cfare mendoni per vendin e ngjarjes?

I pandehuri: Do te kontrolloj nese ata do te na sjellin ndonje gje.

Vesel Alshiqi: Axha Elez, une...

I pandehuri: Ato nuk mjaftojne. Lere te perfundoje sic them une. Une e kam planifikuar cdo gje.

Vesel Alshiqi: A do te perfundoje deri ne fund te vitit?

I pandehuri: Perse jo, patjeter...

Vesel Alshiqi: Çfarë mendoni rreth Afrimit atehere? Ne po flasim tani, ne jemi në këtë biznes tani. Unë dua të di se çfarë mendoni për Afrimin

I pandehuri: Do ta shoh...

Vesel Alshiqi: Sa vjet dot ti marre Afrimi atehere; a do zbrese te me pak se 15 per te?

I pandehuri: Nuk guxoj te bej asgje tani.

Vesel Alshiqi: Vetëm t'ju siguroj axha Elez se kjo nuk ndodhi - ne mënyrën - se si kane evoluar gjërat. Unë

jam një person realist. Unë mund të them se në qoftë se do te ishte ashtu unë do t'ju thoja kjo gjë ishte bere për mua.

I pandehuri: Jo, jo, ju jeni realist, por ju nuk mund të jenë realist në këtë rast.

Vesel Alshiqi: Sa i përket disa gjërave që ata njerëz kanë bërë, ata kanë përmbysur shumë gjëra.

I pandehuri: Tani, kjo gjithashtu mund...

Vesel Alshiqi: Ju nuk jeni vetëm duke me siguruar mua, por ju jeni edhe duke thënë se kjo çështje do të përfundojë deri në fund të vitit

I pandehuri: Duhet te mbyllet.

Vesel Alshiqi: Pra, nuk është e mundur për Gjykatën Supreme që ta liroje Besimin? Më vjen keq, por...

I pandehuri: Ata nuk e praktikojne kete.

Vesel Alshiqi: Pra, ju jeni i sigurtë se rasti do të kthehet te ju brenda një muaji. Me se shumti një muaj nga 28, duke filluar nga 28 dhe atëherë ajo do të kthehet perseri tek ju.

I pandehuri: Ndoshta mund ta mbaje atë pak më gjatë por unë nuk besoj se ata do ta mbajnë atë aq gjatë. Ata ndjekin atë praktikë. Po edhe pse mundet që ta mbajne pak më gjatë, edhe mundet.

...

Vesel Alshiqi: Unë kam qenë i bindur se unë do ta kisha Afrimin, dua të them Besimin, te liruar deri ne 29. Unë mund t'ju siguroj.

I pandehuri: Çdo gjë mund të ndodhë, por gjërat nuk shkojnë në një mënyrë të tillë. Kjo nuk ndodh, nuk ndodhi në këtë mënyrë.

Vesel Alshiqi: ne rregull pra axha Elez, me vjen keq!

I pandehuri: Mund te ndodhe qe edhe une te surprizohem gjithashtu, por nuk veprojne ne kete menyre.

...

Vesel Alshiqi: Vetëm pyesni për këtë! Unë e di që ju nuk mund të pyesni. Ju mund të pyesni dikë se çfarë lloj djali ishte Afrimi. Por kjo o burrë me ka ndodhur mua tashme. Unë po ju them, ju jeni të bindur, se Gjykata Supreme do të kthejë këtë rast te ju.

I pandehuri: Une kam qene i bindur qe nga fillimi per kete dhe jam 100% i sigurte qe do te kthehet.

Vesel Alshiqi: Kam frike axha Elez.

I pandehuri: Ti ske per cfare te kesh frike!

Vesel Alshiqi: Çfarë duhet të bëj tani, hajde me thoni? Nëse nuk e kthejnë atë çfarë duhet të bëj? Për ku te drejtohem tani? Unë nuk e di se nga cila rrugë te shkoj.

I pandehuri: Mos e ki fare merak. Do te kthehet.

...

Vesel Alshiqi: Ai kishte një pasaportë Austriake. Ju gjithashtu i dini disa gjëra në lidhje me gjykatën. Ndjem sikur po ju tregoj se si, madje edhe sekretet shtetërore janë gjetur nga avokatët e tyre. Por askush vetem nuk ishte në gjendje për të marrë telefonatat që ata i kanë bërë Afrimit se unë nuk kam pasur asnjë që të më ndihmojë me diçka, unë mund të te tregoj të vërtetën. Unë po mbeshtetem te ju. Me ndihmo njeri, sepse unë jam në një situatë krize.

I pandehuri: Unë do t'ju them gjatë gjithë kohës deri në ditën e fundit. Por të te them për Afrimin kështu apo ashtu, do të reduktohet shumë. Megjithatë unë nuk mund të them, se sa më shumë pasi që është e mundur të mos ndodhë.

Vesel Alshiqi: Ju jeni shefi i atyre njerezve.

I pandehuri: Ndonjëherë unë i them atyre se "nuk mund të shkojë më tej" edhe pse ata shumë rrallë nuk pajtohen me mua. Por ndonjëherë ata nuk janë dakort

Vesel Alshiqi: Axha Elez, më ndihmoni. Unë jam duke ju thënë përsëri se e kam pjesën tjetër të parave në bankë. Ju mund të thoni çfare të dëshironi

...

Vesel Alshiqi: Prisni pak. Jo, jo! Kam vetëm këte për të thënë. Unë nuk i tradhëtoj fjalët e mia. Te jesh i sigurve se ju do ti merrni 50,000 euro nga unë. Nëse keni nevojë ...

I pandehuri: Jo...

Vesel Alshiqi: Nuk ka asnjë problem nëse keni nevojë për to. Unë do t'ua sjell ato, edhe nëse ju nuk më ndihmoni. Unë e di vetëm një gjë, njeri! Unë dua që ju të më ndihmoni për këtë dhe të përfundojmë me këte. Mjaft është mjaft axha Elez.

...

Ky është përsëri një diskutim në lidhje me parate, në mes të tjerash. I pandehuri informon Vesel Alshiqin se rasti është me Gjykatën Supreme dhe se ai pret që ti kthehet atij.

CD 4²⁴

Biseda ndërmejet Vesel Alshiqit, Ramadan Alshiqit dhe të pandehurit.

Vesel Alshiqi: "...Thjesht erdha për t'ju pyetur nëse ka ndonjë të re".

...

I pandehuri: "Në atë moment, kur unë të heq dorë kur të shoh se unë nuk mund të bëj asgjë unë do t'ju a bëj të ditur, nuk ka asgjë më shumë për të diskutuar"

Ramadan Alshiqi: "...kur ne ju sollem makinën dhe djali jua j erdhi për ta marrë në garazhin tim, a e dinte se prej nga vinte makina?"

²⁴ Prova P8

I pandehuri: "Ne e kemi diskutuar kete tashme."

Ramadan Alshiqi: "...kur moret 130,000 Euro ne shtepine tuaj...si eshte e mundur qe djemte tuaj nuk ju kane pyetur per te tera keto: ku e gjete makinën, ku i gjete 130,000 Euro"

...

I pandehuri: Ju kam thënë më parë se disa gjëra po dalin jashtë kontrollit tim ... unë po perpiqem per sa me mire, por ndonjëherë kur perpiqesh shumë, ne vend te ndrëqesh prish pune..."

...

I pandehuri: "Ne ate moment qe do e shoh qe skam me se cte bej, une do t'ju telefonoj per tju treguar"

...

I pandehuri: " Degjo po te them si edhe me pare, ate dite qe nuk do jem me ne gjendje te merrem me kete , do t'ju telefonoj per te te thene 'Vesel mos prit me asgje nga une, kjo pune ka mbaruar"

...

Vesel Alshiqi: "...tani po thoni qe nuk kam me cfare te bej."

I pandehuri: "Jo, nuk po them keshtu."

...

I pandehuri: "...do bej cdo gje qe kam në dorë atë që unë nuk mund ta bëj - nuk mund ta bëj"

Ky eshte nje diskutim ndermjet te tjerash, per makinën dhe parate.

CD 5

Bisede ndermjet Vesel Alshiqit dhe te pandehurit.

Vesel Alshiqi: ...cili eshte lajmi? Me tregoi babai per ate... sot ishte atje ...cfare mendon, cfare mund te bejme?

I pandehuri: Nuk ka asgje ende.

Vesel Alshiqi: Ore njeri, a e di se cfare po ndodh?
Une thjesht dua te di se cfare po ndodh. Dua ta di
kete, njeri.

I pandehuri: Ende asgje...

Vesel Alshiqi: Me thuaaj!

I pandehuri: A mund ti thoni babait tuaj te mos vije
atje ...

...

I pandehuri: Une do udhetoj per ne nje vend diku afer
jush.

Vesel Alshiqi:...Nese me telefonon prej aty ku mund te
jesh, ne mund te takohemi diku me afer, nese do jesh
afer nesh diku.

I pandehuri: Do jem atje dikur rreth te Premtes apo te
Shtunes ne mengjes.

...

Vesel Alshiqi: Ne mund të takohemi diku dhe të flasim
prapë dhe të bejme diçka, diku në mes. Unë mund t'ju
them tani që ju keni bllokuar situatën tonë, diçka si...

I pandehuri: Mire atehere, do te flasim me vone.

Ky eshte nje diskutim, ndemjet te tjerash, per tu
takuar perseri.

CD 7²⁵

*Bisede ndermjet Vesel Alshiqit, Ramadan Alshiqit dhe te
pandehurit.*

...

²⁵ Prova P8

Vesel Alshiqi: Cfare mendoni Baca Elez, cfare te bejme, ku te shkojme, ne c'drejtim te vrapojme?

I pandehuri: Shiko Vesel, unë kam pritur, edhe pse ata e kanë atë atje, ka ndodhur pikerisht cfare unë kam patur frikë, ata ja kane dhëne atë një paneli që nuk duhet t'ia kishin dërguar. Prandaj ne nuk e dimë se çfare do të ndodhë, nëse ajo kthehet si unë kam pritur, ata do ta bëjne ashtu, në qoftë se jo atehere ka mundësi të tjera, ka një shans që ajo të shkojë ngadalë por përsëri, ne nuk do të heqim dorë nga kjo çështje.

...

I pandehuri: eshte kthyer dhe ata do t'ua japin atyre edhe nje tjetër, Kryetari i Gjykates Supreme e ka kthyer edhe nje here ndoshta per ti hedhur nje sy kesaj.

Vesel Alshiqi: Ky Haxhi Musa, a si e kishte emrin?

I pandehuri: Po.

Vesel Alshiqi: Nuk e di. Po prokurorja. Cfare mund te beje prokurorja aty?

I pandehuri: Asgje per momentin. Ata kane bere ankese mbi aktgjykimin, per aktgjykimin qe eshte marre; ata mendojne qe ishte shume pak dhe kane apeluar per kete gjithashtu.

...

I pandehuri: Lete shohim se cfare po ndodh atje dhe pastaj shohim e bejme, jam i sigurte se cfare po ndodh atje, pasi tani ata duhet, duhet ta kthejne.

Vesel Alshiqi: Unë po te them një gjë, unë besoj dhe jam i bindur se gjykimi do te kthehet, do të kthehet, dhe se do të kthehet në duart tuaja, mos thua asgje sepse ju e dini si ishte marrëveshja, sepse më kane thene Bac Elez, ndoshta kete nuk është mirë ta them, ndoshta edhe babai im dyshon te ju.

I pandehuri: Jo, jo.

...

Ramadan Alshiqi: Une i kam dhene atij 73.000 Euro.

I pandehuri: Jo, jo.

Ramadan Alshiqi: Ua kam dhene vete me duart e mia.

I pandehuri: Jo, shikoni.

Ramadan Alshiqi: Njehere 53,000 e me pas 20,000. Me thua j singërisht vella; me thoni qe ju i keni marre ato, qe une te kem mendimin tim.

I pandehuri: Do t'ju them se nuk e di se sa kam marre. Nuk e di pa marre stilolapsin

...

I pandehuri: Do ju them singërisht qe ai u perpoq 100 here te mi jepte por une nuk i kam marre ato.

Ramadan Alshiqi: Saktesisht.

I pandehuri: Kete po te them, me pas une mund te ulem dhe te te tregoj se sa saktesisht...

...

Ramadan Alshiqi: ...me thua j se sa para te ka dhene ky njeri.

I pandehuri: Do te te tregoj per cdo cent.

...

I pandehuri: Ju, kur, sapo te vijne letrat, une do t'ju dergoj... do t'ju njoftoj me telefon.

Ky është një diskutim, mes te tjerash, në lidhje me, parate. Gjatë kësaj bisede ka referencë të mëtejshme për parate qe i janë dhënë të pandehurit. Ramadan Alshiqi referohet ne ate se i ka dhënë te pandehurit 73.000 euro. I pandehuri nuk e mohon marrjen e parave. Në vend të kësaj ai thotë se "... unë nuk e di se sa kam marrë ..."

Gjatë kësaj bisede Ramadan Alshiqi i referohet asaj se i ka dhënë te pandehurit 73.000 euro. Megjithatë, kur ai dëshmoi më 31 Maj 2010, duke iu referuar Vesel Alshiqit, Ramadan Alshiqi tha

"Ai më tha se i kishte dhënë Elez Hoxhes 123.000 euro dhe se ai solli një makinë për atë nga Austria, ku ai është shtetas. Unë besoj se Elez Hoxha është ende në posedim të asaj makine, ai ia dha atij makinën përmes Agim Zekes."

Gjykata konstaton se, kur ai dëshmoi para Gjykatës, Ramadan Alshiqi ishte thjesht duke u përpjekur të "distanconte" veten nga veprimet e tij të paligjshme.

CD 8²⁶

Bisede midis Vesel Alshiqit, Ramadan Alshiqit dhe te pandehurit.

...

I pandehuri: Unë te thashë që nuk ka rëndësi se çfarë, unë do të bëj çdo gjë që unë mund të

...

Vesel Alshiqi: Unë ju dhashe juve - babai im është i pranishëm këtu - ju tashmë i keni marre 80.000 dhe unë do t'ju sjell dhe një tjetër 50.000 euro vetëm liroi vëllezërit e mi nga burgu ...

Gjate kesaj bisede i pandehuri thote "...Une do te bej gjithcka qe mundem".

CD 9²⁷

Bisede ne mes te Vesel Alshiqit, Naman Alshiqit dhe te pandehurit.

²⁶ Prova P8

²⁷ Prova P8

...

I pandehuri: ...ki kujdes me bisedat...ne telefon

Vesel Alshiqi: ...ketu keni 50,000 Euro me shume...

...

I pandehuri: Degjo, Une do te ndihmoj dhe kur te mbarojme e shohim,

...

I pandehuri: te kam thene qe do bej gjithcka qe mundem deri ne fund...

...

Naman Alshiqi: ...Ju keni marre 80,000 Euro dhe 50,000 me teper...

...

Naman Alshiqi: A kemi ndonje shans apo jo?

I pandehuri: Une besoj qe po, une do te bej cmos deri ne fund.

Naman Alshiqi: ...ato jane ne total 130,000 Euro. Une besoj, nese do te besh me te miren

Vesel Alshiqi: Perfundoje kete pune! Pastaj ku takohemi?

I pandehuri: une i tregoj atij

Gjate kesaj bisede i pandehuri, ndermjet te tjerash thote,
" Une do te bej cmos deri ne fund."

Duke pasur parasysh dëshminë e dëshmitarëve, përmbajtjet e bisedave, kontekstin e tyre dhe pasi jane dëgjuar zërat, Gjykata konstaton se zeri i te pandehurit është një nga zërat regjistruar.

2.2 Video Regjistrimi

Kualiteti i DVD-se mbi të cilën Prokuroria mbështetet²⁸ nuk ishte veçanërisht i mirë. Figura ishte pak e paqartë. Audio ishte i mirë. Gjykata konstaton se në DVD shfaqet i pandehuri dhe Ramadan Alshiqi. Një person tjetër shfaqet gjithashtu. Ky person ishte identifikuar më parë nga Ramadan Alshiqi si djali i tij Vesel Alshiqi....

...

I pandehuri: ketu eshte pjesa tjetere e parave

Ramadan Alshiqi: a jane te gjitha

I pandehuri: ketu jane te gjitha.

Vesel Alshiqi: Bace Elez, a i keni kontrolluar, se mos ato janë të falsifikuara, jeni i sigurt ... A e di njeri se ju i keni marrë ato, a i besoni...

I pandehuri:... ato jane marre nga banka, te tjerat qe me keni sjelle, nuk di asgje tjetere...

[Vazhdon nje bisede lidhur me monedhen e falsifikuar...]

...

Vesel Alshiqi: cfare mendoni, a te perpiqemi perseri me ndonje gje, apo ta perfundojme kete gje/biznes ketu, cdo gje

I pandehuri: Shikoni, ju duhet të provoni, mos u nxitoni me këto gjëra dhe mos dëgjoni cilindo, të keni kujdes se këtu është pak ndryshme se jashtë shtetit, ata të rrënojnë.

Vesel Alshiqi: Çfarë të bëjme? Çfarë mendoni se duhet të bëjmë një apel ... Unë jam i mendimit për një marrëveshje, unë jam për marrëveshje, pasi kur ju nuk mundet ta përfundoni atë, se kështu është bërë dhe tani është në rregull, por desha të them se askush nuk mund ta di, unë nuk e di nëse ju më kuptoni....

I pandehuri: Une te kam thene kur te kryhen keto gjera ju mund te beni lutjen per falje/ pardon

²⁸ Prova P10

...

Ramadan Alshiqi: kam paguar aq sa ata kerkuan...

Ramadan Alshiqi: prit pak, thjesht doja te pyesja, nese na ke borxh.

I pandehuri: me sa di une, jo

Ramadan Alshiqi: Mendohu, mendohu, mendohu perseri, le te takohemi perseri, vetem une edhe ti, kurdo qe te duash dhe flasim nese na ke borxh me shume para apo jo.

I pandehuri: shiko, shiko...

Ramadan Alshiqi: Le te mos bisedojme me gjate ketu

I pandehuri: shiko

Ramadan Alshiqi: Mos thuaj asgje me teper ketu, vetem mendohu nese na ke borxh apo jo

...

Ramadan Alshiqi: ju duhet te organizoni me ta dhe me ne - dhe per te qetesuar gjerat me ta dhe me ne ... Mendoni nese na detyroheni me shume apo jo

I pandehuri: Kur une mendoj, une po mendohem, dhe mendoj..

...

I pandehuri: dhe nese keni diçka, kur ju keni diçka, ejani direkt, pyesni per mua, me degjo, ne qofte se nuk mund te me gjesh te vish perseri, sepse ne qofte se nuk mund te me gjesh, nuk mund te me gjesh, kur une te jem i lire une do te pres ne zyren time

Ramadan Alshiqi: pardon

I pandehuri: ne zyren time, direkt ne zyren time...mos

Ramadan Alshiqi: ne zyren numer

Vesel Alshiqi: ne zyre, zyre

I pandehuri: ne zyre, zyre

Ramadan Alshiqi: ne zyre, zyre, me mire keshtu

I pandehuri: tregoji rojes, qe une jam atje

Gjykata konstaton qe i pandehuri është një nga personat qe paraqitet në DVD. I pandehuri eshte parë ti dorëzoje Ramadan Alshiqit dicka që duket se eshte një zarf i bardhë. Është e qartë nga biseda pasuese dhe konteksti i saj se i pandehuri po i jep Ramadan Alshiqit një zarf që përmban të holla....

2.3 Prova te tjera dokumentuese

Prokuroria ka paraqitur si prove një letër te padatuar²⁹ nga Shoqëria e Sigurimit Austriak Wiener AG Stadtische Versicherung që konfirmoi se siguracioni i automjetit është lëshuar nga kompania në fjale Vesel Alshiqit për periudhen 5 Prill 2005 - 5 prill 2006. Automjeti -subjekt i siguracionit ne këtë rast ishte një Kadi Volkswagen me numër shasi WV1ZZZ9KZWR502284 dhe me targa austriake L - 140CX....

Prokuroria gjithashtu ka paraqitur si evidencë një dokument³⁰ nga Sistemi Informativ i regjistrimit të automjeteve të UNMIK-ut ne Kosove që konfirmoi të njëjtën makinë Volkswagen Kadi të regjistruar më 24 Qershor 2005 në emër të Armend Hoxhes. Certifikata familjare e datës 2 Maj 2002³¹ nxjerrë nga Komuna e Prishtinës konfirmon se Armend Hoxha është djali i te pandehurit....

Gjykata ka nxjerrë si provë një dokument të titulluar "Procesi mbi Vlerësimin e Mallrave' të datës 12 korrik 2010 nga Shërbimi Doganor i Republikës së Kosovës³². Ky dokument konfirmoi vlerën e një Volkswagen Kadi- automjet i prodhuar në 1997 vlera e te cilit ishte vlerësuar, për qëllime doganore, në shumën e 1.200 euro....

²⁹ Prova P6

³⁰ Prova P7

³¹ Prova P12

³² Prova C1

3. Përmbledhje

Neni 343 (1) i KPPK-se mundeson

Personi zyrtar i cili kërkon ose pranon një dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për vete, ose një person tjetër ose që pranon premtimin për dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për të kryer brenda fushëveprimit të autoritetit të tij apo saj zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai ose ajo nuk duhet ta kryejë ose të dështojë për të kryer një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai ose ajo duhet apo mund të ketë kryer dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet....

Nuk kishte asnje diskutim që i pandehuri ishte Kryetari i Trupit Gjykses në gjykimin e Afrim Alshiqit dhe Besim Alshiqit në lenden me numër 54/05 para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Të dy ata janë akuzuar për vrasje.

Për shkak se ai ishte gjykates i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i pandehuri ishte një person "zyrtar" sipas kuptimit të Nenit 343 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës....

Nuk pati asnjë medyshje që Afrim Alshiqi dhe Besim Alshiqi janë shpallur fajtor më 10 Mars 2006 dhe dënuar me burgim afatgjate. Agjyktjykimi u konfirmua nga Gjykata e Supreme në vendimin e saj datë 28 Shtator 2006³³. Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga të dy, Besim Alshiqi dhe Afrim Alshiqi u hodhën poshtë³⁴

Dëshmia më bindëse në këtë rast mund të ishte dhënë nga Vesel Alshiqi. Megjithatë, ai nuk dëshmoi. Në vend të kësaj, Prokuroria thirri Oficerin Prochazka për të dëshmuar në lidhje me atë që Vesel Alshiqi i kishte thënë atij....

Oficeri Prochazka dëshmoi se Vesel Alshiqi deklaroi se ai i kishte dhënë 130.000 euro të pandehurit, duke përfshirë edhe automjetin.

Oficeri Prochazka dëshmoi se Vesel Alshiqi e informoi atë se parate dhe automjeti ishin menduar si një ryshfet për të

³³ A.P. numer 215/06

³⁴ P. kl. Numer 23/2007 date 9 Tetor 2007 dhe P. kl. Numer 1/2008 date 2 Korrik 2008

siguruar lirimin e Afrim Alshiqit dhe Besim Alshiqit.

Oficeri Prochazka dëshmoi në lidhje me hetimin e tij në lidhje me automjetin Volkswagen Kadi. Këto hetime nxoren në dukje se automjeti ishte i regjistruar në emrin e djalit të te pandehurit.

Dëshmia e Oficerit Prochazka u bazua mbi dëshmi thashetheme. Substanca e dëshmisë së tij ishte e bazuar mbi atë që ai tha se Vesel Alshiqi i kishte thënë...

Me 16 Maj 2008³⁵ dhe 10 Qershor 2008³⁶ Ramadan Alshiqi degjoi Cd-te me bisedat e regjistruara³⁷ me te pandehurin. Ai identifikoi zerin e te pandehurit, zërin e tij dhe zerrat e djemve të tij, Vesel Alshiqi dhe Naman Alshiqi. Ai dha të njëjtën dëshmi në seancën e parë kryesore. Ramadan Alshiqi dëshmoi gjithashtu në lidhje me provat DVD mbi të cilën Prokuroria është mbështetur...

Është e qartë se Ramadan Alshiqi ka luajtur një rol me qendror në korrupsionin e te pandehurit me rryshfet nga ai që ai do Gjykatën të besojë. Kështu, Ramadan Alshiqi është përpjekur për të fshehur veprimet e tij të paligjshme. Në vend që të japë dëshmi të drejtpërdrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, Ramadan Alshiqi dëshmoi para Gjykatës se prova e tij ishte, në disa aspekte materiale e rëndësishme, bazuar mbi atë që ai thotë se Vesel Alshiqi i ka treguar. Të dhënat lidhur me shumën e parave që Prokuroria pretendoi se i pandehuri i ka marre dhe provat mbi të cilat Prokuroria është mbështetur në këtë drejtim, kanë krijuar një vështirësi të veçantë për Gjykatën....

Sasi të ndryshme u përmenden gjatë bisedave të regjistruara. Kjo dëshmi është thashethem. Sasia e shumave të përmendura është gjithashtu kontradiktore. Sipas paraqitjes së Prokurorisë i pandehuri ka pranuar rryshfet në shumën e 123.000 euro dhe automjetin. Megjithatë, gjatë një bisede Ramazanit Alshiqi referohet i pandehuri ka pranuar 130.000 euro dhe automjetin³⁸. Kur ai dëshmoi përpara gjykatës në gjykimin e parë kryesor Ramadan Alshiqi përmendi se i pandehuri ka pranuar 123.000 euro dhe një makinë....

³⁵ Prova P3

³⁶ Prova P5

³⁷ CDs 2, 3, 4, 5, 7, 8 and 9

³⁸ CD4

Neni 157 (1) KPPK parashikon që një gjykatë nuk e shpall të pandehurin fajtor bazuar vetëm, ose në një shkallë vendimtare, në dëshmi apo prova të tjera të cilat nuk mund të sfidohen nga i pandehuri apo avokati i tij mbrojtjes nëpërmjet pyetjeve gjatë ndonjë faze të procedurës penale.

Gjykata Supreme e Kosoves³⁹ me të drejtë ka paralajmëruar kundër dhënies se peshës së panevojshme thashethemeve.

Në arritjen e vendimit të saj, Gjykata nuk është mbështetur në shkallë vendimtare, në prova verbale ose të dokumentuara, që nuk mund të sfidohen nga i pandehuri nëpërmjet pyetjeve gjatë ndonjë faze të procedurës penale...

E vetmja dëshmi e drejtpërdrejtë që Gjykata ka dëgjuar lidhur me sasinë e parave që i pandehuri ka marrë është dhënë nga Agim Zeka.

Agim Zeka dëshmoi se ai ishte kontaktuar nga Vesel Alshiqi i cili i kërkoi atij që të veprojë si ndërmjetës në marrëdhëniet e këtij të fundit me të pandehurin.

Agim Zeka dëshmoi që ai kishte marrë 53.000 euro para kesh nga Vesel Alshiqi dhe një Automjet Volkswagen Kadi.

Agim Zeka dëshmoi se ai i dha 53.000 euro të pandehurit me këste. Ai nuk mund të mbante mend datat, por tha se ai i dha një pjesë të parave të pandehurit para se ti jepte djalit të të pandehurit automjetin. Ai tha se djali i të pandehurit kishte marrë automjetin prej tij.

Është e qartë sa i perket provave se Vesel Alshiqi e siguroi automjetin Volkswagen Kadi për periudhën 5 Prill 2005 - 5 prill 2006⁴⁰ Më 25 qershor 2005 po i njëjti automjet ishte regjistruar në emrin e djalit të të pandehurit.

I pandehuri pohoi se djali i tij kishte blerë një makinë nga Agim Zeka. Gjykata dëgjoji dëshmi nga Agim Zeka që djali i të pandehurit kishte blerë një makinë prej tij në vitin 2000. Automjeti në këtë rast është një makinë tjetër.

³⁹ AP-KZ. No. 368/2009 Danil Nokaj

⁴⁰ Prova P6

Edhe pse djali I te pandehurit e kishte regjistruar automjetin ne emrin e tij, Gjykata konstaton se ishte i pandehuri ai qe i kishte marre automjetin per djalin e tij.

I pandehuri e mohoi se, ai personalisht ose nËpËrmjet nË ndËrmjetËsi, kishte marrË para nga ndonjË anËtar i familjes Alshiqi,. Gjykata nuk e ka pranuar dËshminË e tij nË kËtË drejtim....

I pandehuri e mohoi se zeri i tij ishte nË nga zËrat tË regjistruar nË CD apo se ai ishte nË nga personat e paraqitur nË DVD. Gjykata dËgjoi deklaratën e Ramadan Alshiqit se ai ishte i pranishËm kur disa ⁴¹ prej CD-ve janË regjistruar. Ai ishte gjithashtu i pranishËm nË takimin e paraqitur nË DVD. Ramadan Alshiqi dËshmoi rreth identifikimit qe ai i beri zËrave nË CD pËrfshirË ketu zerin e tij, ate te te pandehurit dhe tË djemve tË tij. NË keto rrethana Gjykata konstatoi se nuk ishte e nevojshme pËr tË marrË dËshmi te ekspertit lidhur me kryerje te analizave te zËrit...

Gjykata konstaton se zËri i te pandehurit ËshtË nË secilen nga shtatË CD-te dhe ne DVD-ne, mbi tË cilat Prokuroria mbËshtetet, dhe referenca e te cilave ËshtË bËrË kËtu.

Bisedat e regjistruara nË mes tË pandehurit dhe anËtarËve te familjes Alshiqi zbulojnË nË irritim ose zhgËnjim nË rritje nË atË qË ËshtË perceptuar si pafuqi e te pandehurit nË gjetjen e nË zgjidhje pËr situaten e veshtire te vËllezËrve Alshiqi. ZhgËnjimi duket se arrin kulmin nË DVD kur i pandehuri mund tË shihet duke i dorËzuar nË zarf Ramadan Alshiqit. ËshtË e qartË nga regjistrimi i zËrit qË pandehuri po i jep para Ramadan Alshiqit....

Ramadan Alshiqi deklaroi se zarfi kishte perafersisht 59.000 ose 61.000 euro. Ai nuk mund tË kujtoj saktËsisht. Gjykata konstaton se i pandehuri ishte duke kthyer paratË ryshfet.

Gjykata konstaton se i pandehuri kam marrË nga Vesel Alshiqi pËrmes Agim Zekes te holla nË shumËn totale prej 53.000 euro dhe nË makinË Volkswagen Kadi. Vlera e pËrafËrt e kËtij automjeti pËr qËllime doganore ËshtË 1.200 euro.

⁴¹ CD's 3, 5 and 7

Gjykata konsaton se i pandehuri ka marrë shuma të mëtejshme nga familja Alshiqi por Prokuroria nuk ka provuar shumën e saktë. Gjykata konstaton se i pandehuri i ka kthyer familjes Alshiqi para ne dore në shumën e 59.000 apo 61.000 euro...

Edhe pse provat janë te paqarta në lidhje me datat e sakta I pandehuri ka marrë para nga familja Alshiqi, Gjykata konstaton sipas dokumentit⁴² te regjistrimit të automjeteve të Sistemit te Informacionit te UNMIK-ut në Kosovë se automjeti Volkswagen motorike Kadi ishte regjistruar në emër të Armend Hoxhes⁴³ më 24 Qershor, 2005. Kjo ishte para datës së aktgjykimit në rastin e Afrim dhe Besim Alshiqit⁴⁴.

Agim Zeka dëshmoi se ai i dha të pandehurit një pjesë te parave që ai kishte marrë nga Vesel Alshiqi para se djali i te pandehurit te merrte Volkswagen Kadi.

Kadi Volkswagen ishte regjistruar në emrin e djalit te te pandehurit më 24 Qershor 2005. Llogjikisht del se Agim Zeka i dha te pandehurit disa të holla para datës së aktgjykimit.⁴⁵

Sipas Gjykates del se rrethanat kane komplotuar kundër te pandehurit dhe parandaluan manipulimin e tij në përfundimin e gjykimit të parë si ai e kishte menduar.

Megjithatë, i pandehuri haptaz priste qe Gjykata Supreme t'ia kthente rastin atij për rigjykim.

I pandehuri pohoi se provat e familjes Alshiqi në konspiracion me Agim Zeken ishin te fabrikua dhe thjesht një hakmarrje për faktin se i pandehuri kishte shpallur fajtoresh Besim Alshiqin dhe Afrim Alshiqin dhe i dënoi ata me burgim afatgjatë....

Më tej, ose si alternativë i pandehuri pohoi se ndjekja e tij penale ishte pjesë e një skeme të përpunuar për të siguruar një gjykim të ri të Besim Alshiqit dhe Afrim Alshiqit.

I pandehuri pretendoi se ai kishte marrë personalisht kërcënime nga familja Alshiqi dhe keto sipas pohimeve te

⁴² Prova P7

⁴³ Prova P7

⁴⁴ Aktgjykimi eshte shpallur ne 10 Mars 2006

⁴⁵ 10 Mars 2006

tij, janë rezulttat i dënimit te Besim Alshiqit dhe Afrim Alshiqit nga paneli i tij. Ai tha se nuk raportoi ndonjë nga këto kërcënime në polici ose te stafi pergjegjes për sigurinë e Gjykatës se Qarkut. Nëse i pandehuri kishte marrë vërtet kërcënime nga anëtarët e familjes Alshiqi ai do ti kishte raportuar ato te autoritetet.

Pohimet mbi të cilat I pandehuri u mbështet gjatë mbrojtjes së tij dhe të cilat ne i kemi përmendur janë hedhur poshtë nga Gjykata. Mbrojtja e tij ishte një trillim i sajuar për të fshehur faktin dhe shkallen e veprimit te tij të paligjshem.

Gjykata konstaton se i pandehuri, ndërsa një gjyqtar i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës dhe si rrjedhojë person zyrtar në kuptim të Nenit 343 të KPPK-së, me ndërmjetësimin e Agim Zekes, ka pranuar nga Vesel Alshiqi para në shumën 53.000 Euro dhe një automjet Kadi Volkswagen, të cilën ai e mori për djalën e tij dhe se ai ka pranuar me tej nga Vesel Alshiqi shuma të tjera parash, të gjitha me qëllim që ai të kryejë brenda fushëveprimit të autoritetit të tij zyrtar një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai nuk duhet ta kishte kryer ose të dështojë për të kryer një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai duhet te kishte kryer, konkretisht lirimimin e Afrim Alshiqit dhe / ose Besim Alshiqit që ishin te akuzuar për vrasje, ose, qe atyre tu shpallej një denim me i butë. Në një takim të mëvonshëm në praninë e Vesel Alshiqit dhe Ramadan Alshiqit, në shtëpine e ketyre te fundit, i pandehuri i dha Ramadan Alshiqit një zarf që përmban të holla në shumën prej rreth 59.000 euro ose 61.000 euro duke qene keto, një pjesë e parave ryshfet qe i pandehuri kishte marrë nga Vesel Alshiqi.

Drejtesia dhe trajtimi I barabarte perpara ligjit janë parimet themelore në thelb të çdo shoqërie demokratike. Ne mbështesim ata që mbrojnë besimin ne zyren juridike dhe besimin e popullit për mbrojtje të te drejtave dhe lirive individuale. Gjykatësit shpesh janë gjithcka që qëndron në mes të shoqërisë se lire të ndershme dhe demokratike dhe tiranise. Kur gjyqtarët janë të korruptuar peshorja e drejtësisë korruptohet në favor të kriminalitetit. Zëra të pafajshëm vazhdojne te mbeten te padëgjuar, faji pa u ndëshkuar dhe struktura e shoqërisë shperbehet.

Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e këtij rasti ne mjaftohemi me ate se dënimi është i arsyeshem dhe

proporcional.

Si rrjedhoje e arsyeve te lartpermendura ne shpallim kete aktgjykim

Me date 14-te Korrik 2010.

Gjyqtar - Malcolm Simmons
Kryetar i Trupit Gjykses

Procesmbajtes

KESHILLE LIGJORE: Sipas Nenit 398 (1) te Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë të këtij aktgjykimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur nje kopje e aktgjykimit është shërbyer.ⁱ

ⁱ Translated from English by ARW

